

Mediat JO-sociale II:

Gjuha e urrejtjes sensacionaliste *online*
ndaj grave në politikë

2025




E drejta e autorit © 2025. **Democracy for Development (D4D)**. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Përveç citimeve të shkurtra për qëllime kritike dhe rishikimi, asnjë pjesë e kësaj publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në çfarëdo sistemi të rikthimit të të dhënave, apo të transmetohet në çfarëdo forme apo përmes çfarëdo mjeti, qoftë elektronik, mekanik, fotokopjues, regjistruar apo tjetër, pa lejen paraprake të D4D.

Ky raport u përgatit në kuadër të projektit “*Mbështetje për Shoqërinë Civile në Kosovë*”, i financuar nga Dukata e Madhe e Luksemburgut dhe i implementuar nga LuxDev, Agjencia e Luksemburgut për Bashkëpunim Zhvillimor. Analiza u krye në partneritet me National Democratic Institute – NDI, përmes Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim – SDC, si dhe me Pikasa Analytics.

Qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë patjetër pikëpamjet e NDI-së, Dukatës së Madhe të Luksemburgut, Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, apo të individëve të lidhur me organizatat e lartpërmendura.



Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



Përmbajtja

Përmbledhje	4
Metodologjia.....	5
Analizë krahasuese: Mediat JO-sociale I (2023) kundrejt Mediat JO-sociale II (2025).....	6
▶ Trendet e përgjithshme	6
▶ Gratë kundrejt burrave gjatë fushatës elektorale.....	6
▶ Partitë politike: Partitë në pushtet kundrejt opozitës.....	7
▶ Zgjedhjet lokale kundrejt zgjedhjeve parlamentare	8
▶ Vazhdimësia dhe ndryshimi ndërmjet analizave në Mediat JO-sociale I dhe Mediat JO-sociale II	9
Gjetjet / Rastet kryesore.....	10
▶ Shtrirja dhe përhapja e gjuhës së urrejtjes	10
▶ Intensifikimi i sulmeve mizogjene gjatë krizave politike	10
▶ Fjalët kyç seksiste të përsëritura dhe seksizmi i strukturuar <i>online</i> ..	11
▶ Modelet e gjuhës seksiste dhe objektivizimit të bazuara në raste	11
Dezinformimi me bazë gjinore	13
Gjuha e urrejtjes	20
AI dhe <i>Deepfake</i>.....	23
Komunitet jo-shumicë	32
Sensacionalizmi	35
Rekomandime	37

Përmbledhje

Ky raport shqyrton mjedisin informativ në media sociale gjatë zgjedhjeve parlamentare dhe lokale të vitit 2025 në Kosovë, duke analizuar dinamikat digjitale politike në të dy nivelet e qeverisjes. Duke mbuluar periudhën nga dhjetori 2024 deri në nëntor 2025, raporti ofron një vlerësim gjithëpërfshirës të mënyrës se si diskursi *online* ndikon në pjesëmarrjen politike dhe në perceptimin publik. Studimi fokusohet në katër fusha kyç: dhuna ndaj grave në politikë (ang. *Violence Against Women in Politics*, e njohur me akronimin VAW-P) në mjedise *online*; çrregullimet e informacionit me bazë gjinore; sjellja e koordinuar jo-autentike; dhe përdorimi i inteligjencës artificiale në politikë.

Me zgjerimin e angazhimit digjital, përfaqësimi edhe ashtu i brishtë i grave në sferën publike përballët me presione gjithnjë e më të shtuara. Analiza tregon se dhuna *online* ndaj grave në politikë është sistemore, përdoret në mënyrë strategjike dhe shpesh i jepen ngjyime sensacionaliste për të gjeneruar angazhim të lartë. Gratë në politikë ekspozohen në mënyrë të vazhdueshme ndaj sulmeve

mizogjene, të seksualizuara dhe të ngarkuara me elemente morale, të cilat e zhvendosin vëmendjen nga debatet programore dhe politikat publike, duke instrumentalizuar jetën e tyre private, pamjen apo marrëdhëniet personale. Përmbajtjet e vendosura në suaza satirike ose argëtuese shpesh e maskojnë armiqtësinë, duke mundësuar përhapjen e gjerë të narrativave mizogjene. Gratë nga komunitetet jo-shumicë përballen me diskriminim të shumëfishtë, ku sulmet me bazë gjinore ndërthuren me retorikë etnike apo nacionaliste. Raporti konstaton se këto narrativa shpesh janë të koordinuara, amplifikohen përmes rrjeteve partiake dhe përkeqësohen më tej nga dobësitë e platformave digjitale dhe përmbajtjet e reja të gjeneruara me inteligjencë artificiale (ang. *Artificial Intelligence*, në vijim AI). Në përgjithësi, rritja e dukshmërisë gjatë cikleve elektorale e shton ekspozimin e grave ndaj abuzimit *online*, duke minuar kredibilitetin, autoritetin dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në jetën politike.

Metodologjia

Ky raport bazohet në monitorim sistematik të 162 mediave në Kosovë dhe të aktivitetit të tyre në platformat kryesore të rrjeteve sociale — Facebook, TikTok, Instagram, YouTube dhe LinkedIn. Monitorimi u fokusua në identifikimin e formave të çrregullimeve të informacionit, përfshirë keqinformimin, dezinformimin, sensacionalizmin, mizogjininë dhe gjuhën e urrejtjes.

U aplikua një qasje e kombinuar metodologjike. Në aspektin sasior, studimi ndoqi treguesit e angazhimit (shikime, ndarje, komente), frekuencën e shkeljeve, si dhe shpërndarjen gjinore (%) të përdoruesve që prodhojnë gjuhë urrejtjeje, duke e matur kryesisht përmes seksioneve të komenteve në Facebook. Në aspektin cilësor, u përdorën mostrat narrative dhe hartëzimi i rrjeteve për të analizuar mënyrën se si qarkullon përmbajtja, cilat tema dominojnë dhe si komunitetet *online* i amplifikojnë narrativat specifike. Analiza mbështetet në disa burime të dhënash:

- Përmbajtje online nga 162 media;
- Postime në rrjetet sociale dhe komente të përdoruesve;
- Gjetjet krahasuese nga edicioni i parë (2023) dhe i dytë (2025) i publikimit *Mediat JO-sociale*.

Analiza krahasuese u realizua përgjatë tri dimensioneve:

- Gratë kundrejt burrave në politikë;
- Partitë e mëdha kundrejt partive të reja;
- Aktorët politikë lokalë kundrejt atyre kombëtarë.

Kjo qasje mundëson një pasqyrë të qartë të trendeve, ndryshimeve dhe intensitetit të diskursit *online* gjatë periudhës së raportimit.

Analizë

krahasuese: Mediat JO-sociale I (2023)

kundrejt Mediat JO-sociale II (2025)

► Trendet e përgjithshme

Dhuna *online* ndaj grave në politikën e Kosovës mbetet e vazhdueshme dhe dinamike. Ajo po bëhet gjithnjë e më e sofistikuar, ku përdorimi i AI, *meme*-t dhe polarizimi partiak kontribuojnë në amplifikimin e sulmeve. Pa ndërhyrje të synuara nga institucionet,

mediat dhe partitë politike, hapësirat digjitale të sigurta për gratë, veçanërisht për gratë e reja, përfaqësueset e komuniteteve jo-shumicë apo ato nga forcat politike të reja, po ngushtohen gjithnjë e më shumë.

► Gratë kundrejt burrave gjatë fushatës elektorale

Gratë mbeten objektivat kryesore të dezinformimit me bazë gjinore, dhunës *online* dhe

mizogjinisë. Në vitin 2023, 89.6% e komenteve me gjuhë urrejtjeje u prodhuan nga burrat, kundrejt

10.4% nga gratë. Në vitin 2025, dominimi i burrave si autorë të komenteve të tilla është rritur edhe më tej, në 96.2% komente nga burrat, kundrejt vetëm 3.8% nga gratë. Politikanët [burra] zakonisht përballen me kritika ideologjike ose të lidhura me performancën, ndërsa gratë sulmohen përmes:

- De-legitimimit moral (vënia në dyshim e ndershmërisë apo e vlerës së tyre);
- Turpërimit të seksualizuar ose të bazuar në pamje fizike;

- Infantilizimit dhe minimit të kapaciteteve intelektuale.

Cenueshmëritë e ndërthurura mbeten të pranishme: gratë nga komunitetet jo-shumicë (p.sh. deputetet boshnjake) përballen me sulme që ngërthejnë elemente etnike krahas armiqësisë me bazë gjinore, një targetim i dyfishtë që rrallë vihet re ndaj burrave. Sulmet *online* me bazë gjinore shfaqen në mënyrë të qëndrueshme gjatë gjithë vitit, duke u intensifikuar veçanërisht gjatë periudhave elektorale ose momenteve të pasigurisë politike.

► Partitë politike: Partitë në pushtet kundrejt opozitës

Gratë në partitë në pushtet ose në pozita me profil të lartë përballen me:

- Narrativa të servilitetit ose varësisë nga liderët burra;
- Akuza për korrupsion të vendosura në suaza gjinore;
- Përmbajtje satirike ose të bazuara në *meme* që e trivializojnë rolin e tyre politik.

Gratë në opozitë paraqiten shpesh si të parëndësishme, oportuniste ose të udhëhequra nga emocionet, posaçërisht rreth negociatave për koalicione apo kritikave ndaj qeverisë. Konkurrenca partiake nuk e kanalizon debatin drejt kritikës programore, por përkundrazi i amplifikon sulmet me bazë gjinore, me narrativa mizogjene të mishëruara në ekosistemet partiake, pavarësisht përkatësisë politike.

► Zgjedhjet lokale kundrejt zgjedhjeve parlamentare

Në nivelin nacional, gratë [politikane] përballen me sulme që lidhen me rolet institucionale dhe çështje me peshë të lartë politike (p.sh. dialogu Kosovë-Serbi, kriza energjetike, ngërçi kushtetues), të vendosura në suaza të legjitimitetit, lojalitetit ose keqbërjeve partiake.

Në zgjedhjet lokale, kandidatet përballen me tallje të hiper-lokalizuara, vendosje në suaza

të sferës shtëpiake dhe narrativa të paaftësisë, duke i paraqitur më shumë si figura dekorative sesa si aktore serioze politike. Fushatat në nivelin nacional gjenerojnë sulme të politizuara me vëllim të madh, ndërsa fushatat lokale prodhojnë poshtërim të personalizuar në nivel komuniteti. Të dyja nivelet kontribuojnë në krijimin e një mjedisi armiqësor që dekurajon pjesëmarrjen e grave në politikë.

► **Vazhdimësia dhe ndryshimi
ndërmjet analizave në Mediat
JO-sociale I dhe Mediat JO-
sociale II**

Trendi kyç	2023 (Mediat JO-sociale I)	2025 (Mediat JO-sociale II)
1. Nga dezinformimi me bazë gjinore drejt ekosistemeve të integruara të dhunës online	Dezinformimi me bazë gjinore shihet si një formë e veçantë e çrregullimit të informacionit, që minon lidershipin e grave dhe ushqen polarizimin politik.	Dezinformimi me bazë gjinore, gjuha e urrejtjes, përmbajtjet e gjeneruara me AI dhe sensacionalizmi janë të ndërthurura. Dezinformimi, mizogjinia dhe përmbajtjet argëtuese (<i>clickbait</i> , <i>meme</i> , satirë) veprojnë së bashku, duke i bërë sulmet më të shpeshta, më të shpërndara dhe më të vështira për t'u kundërshtuar.
2. Thellimi i hendekut gjinor mes autorëve të sulmeve	89.6% e komenteve me gjuhë urrejtjeje u prodhuan nga burra; pjesëmarrja e grave ishte ende e dukshme në një masë të kufizuar.	Mbi 96% e komenteve me gjuhë urrejtjeje u prodhuan nga burra, duke treguar një konsolidim të mbizotërimit të burrave në rolin e “portierit” në diskursin publik.
3. Zgjerimi i kanaleve dhe rritja e sulmeve të përforcuara nga AI	Rrjetet sociale dhe portalet online luajnë rol qendror në përhapjen e dezinformimit dhe gjuhës së urrejtjes me bazë gjinore.	Videot në rrjetet sociale dhe përmbajtjet e gjeneruara me AI apo mediat sintetike (ang. <i>deepfake</i>) janë kthyer në mjete kyç për poshtërimin e grave [politikane], trivializimin e imazhit të tyre ose fabrikimin e narrativave të rreme.
4. Nga shpërthime sporadike drejt armiqësisë së normalizuar përgjatë cikleve elektorale	Rritje të theksuara të dhunës online të lidhura me ngjarje apo skandale specifike; patriarkati strukturor tashmë i identifikuar.	Armiqësi e qëndrueshme dhe sisteme përgjatë zgjedhjeve parlamentare dhe lokale; sulmet mizogjene vazhdojnë gjatë fushatave, negociatave në Kuvend dhe garave lokale, duke u shndërruar në një dukuri konsistente të sferës digjitale në Kosovë.

Gjetjet / Rastet kryesore

► Shtrirja dhe përhapja e gjuhës së urrejtjes

Analiza e 660,758 komenteve tregon se 14% e tyre (91,525 komente) përmbanin gjuhë urrejtjeje të drejtuar ndaj grave në politikë. Kjo normë e qëndrueshme përgjatë një trupi kaq të madh të të dhënave dëshmon se ekziston një model sistemor dhe i vazhdueshëm i armiqësisë me bazë gjinore, ku disa gra [deputetet] janë veçanërisht të ekspozuara ndaj

niveleve të larta të abuzimit në mënyrë të synuar. Gjetjet tregojnë se diskursi mizogjen është i mishëruar në mënyrë strukturore në mjedisin politik *online* në Kosovë dhe funksionon si një tipar i qëndrueshëm i debatit publik, i intensifikuar nga zhvillimet politike, e jo si një përjashtim i shkaktuar nga ngjarje të izoluara.

► Intensifikimi i sulmeve mizogjene gjatë krizave politike

Gjuha mizogjene dhe fushatat e koordinuara të dezinformimit intensifikohen rreth zhvillimeve të mëdha politike dhe shoqërore, përfshirë: konstituimin e Kuvendit; krizën energjetike; dialogun Kosovë-Serbi dhe tensionet në veri.

Gjatë këtyre momenteve, gratë bëhen objektiva të sulmeve në mënyrë jo-proporcionale, duke shërbyer si “valvula simbolike” për ankthet më të gjera politike. Modelet e identifikuara pasqyrojnë mizogjini oportuniste (shfrytëzimin e

krizave për të minuar gratë në pushtet) si dhe devijim të fajësimit me bazë gjinore

(drejtimin e përgjegjësisë ndaj grave gjatë periudhave të stresit institucional).

► Fjalët kyç seksiste të përsëritura dhe seksizmi i strukturuar *online*

Të dhënat tregojnë një fjalor të qëndrueshëm të mizogjinisë digjitale, duke dëshmuar se armiqësia *online* ndaj grave ndjek modele të dallueshme dhe të përsëritshme. Këto modele grupohen, por nuk kufizohen, në katër kategori kryesore dominuese, si:

- De-legitimimi moral;
- Turpërimi i seksualizuar;

- Infantilizimi patronizues;
- Minimi intelektual.

Këto kategori kyç pasqyrojnë një seksizëm të kodifikuar, të mishëruar në diskursin e përditshëm politik.

► Modelet e gjuhës seksiste dhe objektivizimit të bazuara në raste

Shqyrtimi i rasteve kryesore nxjerr në pah forma të përsëritura të çrregullimeve të informacionit, armiqësisë dhe manipulimit narrativ me bazë gjinore:

- *Objektivizim i mundësuar nga mediat*

Gratë [deputete] vendosen në suaza të pamjes fizike dhe jo të punës politike apo përmbajtjes programore,

duke fshirë substancën e rolit të tyre politik.

- *Shkatërrim moral dhe de-legitimim institucional*

Fyerjet e seksualizuara dhe akuzat moralizuese synojnë kredibilitetin dhe legjitimitetin institucional të grave.

- *Tallje dhe skualifikim i nënkuptuar*

Komentet përçmuese nënkuptojnë se pamja apo sjellja e grave është shenjë paaftësie; kjo dukuri ishte e përhapur përgjatë mbulimit të fushatës elektorale të vitit 2025.

- *Satirë përçmuese dhe mizogjini e sensacionalizuar*

Humori dhe përmbajtjet që nxisin klikime (ang. *clickbait*) i amplifikojnë tropet mizogjene me një nivel të reduktuar llogaridhënieje.

- *Mizogjini politike dhe anshmëri të ndërthurura*

Gratë nga komunitetet jo-shumicë përballen me sulme të shumëfishta, të cilat ngërthejnë ngjyrimë seksiste dhe elemente etnike.

- *Mizogjini simbolike dhe retorikë poshtëruese*

Disa narrativa eskalojnë në poshtërim dhe gjuhë ngacmimi të synuar, duke përforcuar normat kufizuese dhe diskriminuese.

Dezinformimi me bazë gjinore

Kategoria:


Shkatërrim moral dhe de-legjitimim institucional

“Vjosa Osmani e poshtëruar në Amerikë”

112 reagime

93 komente

11 shpërndarje



Pëlqej



Koment





Shpërndaj

Artikulli paraqet një rrjedhë të qartë argumentuese, por suazat që krijon mbështeten kryesisht në gjuhë nxitëse dhe paragjyquese, e cila përputhet me modelët e dezinformimit me bazë gjinore dhe të de-legjitimitit moral. Përdorimi i termave si “e poshtëruar”, “dështuar” apo “katandisur në nivelin më të ulët” përbën retorikë sensacionaliste dhe denigruese, e cila synon të imponojë një gjykim negativ, në vend se të ofrojë një analizë të

bazuar në prova faktike. Kjo qasje pasqyron taktika të zakonshme që përdoren për të minuar gratë në politikë, duke zhvendosur narrativën nga konteksti institucional drejt degradimit emocional. Duke i paraqitur akuzat subjektive si analizë dhe duke anashkaluar perspektivën e institucionit të përfshirë, artikulli shkel parimet e raportimit të balancuar dhe përforcon një narrativë moralizuese që dëmton

kredibilitetin; tipike për sulmet politike me bazë gjinore.¹

“Doarsa Kica Xhelili: Politikane e dyfishtë, bredharake dhe manipulatore e procesit politik në Kosovë”



Në mënyrë të ngjashme, ky artikull paraqet një shembull të dezinformimit me bazë gjinore dhe të de-legitimimit moral përmes përdorimit të gjuhës shpifëse, fyese dhe jo-faktike. Në vend se të angazhohet në kritikë politike apo të bazuar në politika publike, teksti mbështetet në fyerje me bazë gjinore që synojnë të minojnë kredibilitetin përmes degradimit të karakterit. Kjo qasje përputhet me taktika të zakonshme që përdoren për të targetuar gratë në politikë, duke e lidhur integritetin publik me

sjelljen personale dhe duke e vendosur angazhimin e tyre politik në suaza të gjykimit moral, e jo të performancës institucionale.

Duke i paraqitur këto sulme nën petkun e gazetarisë, artikulli shërben si dezinformim që shkakton dëme të reputacionit, duke përforcuar narrativa të dëmshme që kontribuojnë në një ekosistem më të gjerë të manipulimit gjinor në diskursin publik.²

¹ <https://paparaci.com/532601/vjosa-osmani-e-poshteruar-ne-amerike/>

² <https://www.drini.us/author/drini-us/page/6/>

Kategoria:

Çrregullim i informacionit me bazë gjinore -
Shkatërrim moral


8 artikuj

“Ajo ka nevojë për
trajtim psiko-social”

334 reagime

267 komente

44 shpërndarje



Pëlqej



Koment



Shpërndaj

Artikulli përbën shembull të qartë të një sulmi personal me bazë gjinore që synon stigmatizimin. Duke përdorur terminologjinë e shëndetit mendor si fyerje, diskursi e zhvendos vëmendjen nga argumentet politike drejt nënkuptimit të një mangësie psikologjike të supozuar. Vendosja në suaza të tilla shërben si mjet diskreditues dhe jo si kritikë legjitime.

Duke qenë se objektivi është një grua [politikane], përdorimi i gjuhës së bazuar në shëndetin mendor përputhet me modele të njohura gjinore që i paraqesin gratë si “jo-stabile” apo “emocionale”, me qëllim zhvlerësimin e qëndrimeve të tyre politike. Kjo retorikë përforcon stereotipa të dëmshëm dhe de-legjitimon pjesëmarrjen e grave në jetën publike.³

³ <https://kosovaime.tv/ajo-ka-nevoje-per-trajtim-psiko-social-ramabaja-i-ashper-me-deputeten-musliu/>

Kategoria:

Çrregullim informacioni me bazë gjinore


11 artikuj

“Peshkimi” i deputetëve, shtohen zërat se Kurti ka blerë deputetë të opozitës për të formuar qeverinë re”

289 reagime

282 komente

25 shpërndarje



Pëlqej



Koment



Shpërndaj

Artikulli pretendon se kryeministri Kurti ka “blerë” deputetë të opozitës, duke përdorur deputeten Adelina Grainca si shembullin kryesor. Vënia në pah e kalimit të saj nga një parti në tjetrën në vitin 2021 si dëshmi e supozuar e “peshkimit” minon autonominë e saj politike dhe pasqyron një model më të gjerë, në të cilin gratë [deputete] paraqiten si lehtësisht të ndikueshme ose të manipulueshme. Vendosja në këto suaza përforcon stereotipat gjinorë dhe zhvendos dyshimin mbi një grua [politikane] pa ofruar prova faktike.⁴


Gjatë gjithë fushatës, vazhduan të jenë të dukshme modele të ngjashme të armiqësisë *online*, ku komentimi shpesh largohej nga debati politik dhe përqendrohej në sulme personale. Kjo pasqyron një prirje më të gjerë që gratë [politikane] të targetohen përmes taljes me bazë gjinore, objektivizimit dhe stigmatizimit, në vend të një kritike përmbajtësore.

⁴ https://nacionale.com/politike/peshkimi-i-deputeteve-shtohen-zerat-se-kurti-ka-blere-deputete-te-opozites-per-te-formuar-qeverine-re?fbclid=IwY2xjawN9jtlehrua2flbqixmqbicmlketeymutubnk5tftmtfqv01fc3j0ywwzhchbfawqqmjyymdm5mtc4odiwdmg5mgabhhdqnpgr6bnnlnoorpdogqx2kcpudli6odpfq102-veqsj742rgei6fr6_aem_9mptmdswwlk3ythvd70xag



Kategoria:

Dhunë online ndaj grave në politikë – sulme ndaj reputacionit me motiv gjinor



"Dil voto!"


600 pëlqime

114 komente

15 komente negative

4 editime

30 fjalë abuzuese



Një postim publik i deputetes Fitore Pacolli, i shoqëruar me mbishkrimin "Dil voto!", u shndërrua në një shembull të qartë të ngacmimit *online* me bazë gjinore, ku seksioni i komenteve u zhvendos nga angazhimi me qytetarë për të votuar drejt sulmeve personale që synonin minimin e kredibilitetit të saj përmes gjuhës specifike gjinore. Në vend se të trajtonin çështje politike apo përmbajtje programore, komentuesit u mbështetën në gjykime morale dhe akuza që e paraqisnin atë si qenësisht jo të besueshme, duke përdorur etiketime me ngjyrime femërore për të intensifikuar poshtërimin dhe

për të cenuar pozitën e saj si grua në politikë.

Ky model tregon se si hapësirat *online* mund të shfrytëzohen, goftë në mënyrë të qëllimshme apo organike, për të diskredituar gratë dhe për të devijuar vëmendjen nga substanca politike. Rasti pasqyron një prirje më të gjerë në mjedisin digjital të Kosovës, ku gratë në jetën publike përballen me sulme të synuara ndaj karakterit, të cilat normalizojnë armiqësinë dhe

dekurajojnë pjesëmarrjen e tyre politike.⁵

"Blerta thote se ka acarim raportesh mes Presidences dhe Qeverise"

29 pëlqime

24 komente

 Pëlqej

 Koment

 Shpërndaj

Një raport që citonte një deklaratë publike të deputetes Blerta Deliu-Kodra nxiti angazhim të kufizuar, por seksioni i komenteve u zhvendos shpejt drejt sulmeve personale me bazë gjinore, ku vërejtjet u përqendruan në gjininë, pamjen dhe përkatësinë e saj politike, e jo në përmbajtjen e mesazhit të saj. Diskutimi përmbante gjuhë shpërfillëse dhe nënçmuese, me qëllim minimin e kredibilitetit të saj si grua në politikë, pa asnjë debat substancial politik apo institucional.

Pavarësisht nivelit të ulët të ndërveprimit të përgjithshëm, përqendrimi i komenteve armiqësore pasqyron një prirje më të gjerë në mjedisin digjital të Kosovës, ku gratë [politikane] dhe veçanërisht ato nga partitë opozitare përballen me agresion *online* në mënyrë jo-proporcionale, i cili fokusohet në denigrim personal dhe jo në kritikë programore apo institucionale.⁶

⁵ <https://www.facebook.com/reel/1348878723609609>

⁶ <https://www.facebook.com/549603483862686/posts/1193521806137514>

Gjuha e urrejtjes

Kategoria:

Gjuhë urrejtjeje politike dhe denigrim personal

“Kadrijaj: Vendi nuk guxon të mbetet peng i Kurtit dhe Vetëvendosjes”



Pëlqej



Koment



Shpërndaj

Një artikull lajmi mbi deklaratat pas seancës së 46-të të dështuar konstituive nxiti një seksion komentesh me angazhim shumë të lartë, ku diskutimi u zhvendos shpejt nga çështja parlamentare drejt denigrimit personal armiqësor. Përgjigjet u dominuan nga fyerje me bazë moshe, akuza morale, pretendime konspirative dhe shprehje


vulgare, ndërsa shpërndarja e vegëzave (ang. *links*) jo-relevante e shprishi më tej diskutimin. Modeli i përgjithshëm tregon se si lajmet politike me angazhim të lartë mund të devijohen në sulme personale të motivuara politikisht, duke e zbehur llogaridhënien institucionale dhe duke dobësuar debatin publik konstruktiv.⁷

⁷ <https://www.facebook.com/614901927330200/posts/1214647397355647>

Kategoria:

Gjuhë urrejtjeje e motivuar politikisht

"Këta "qytetarë" më të zellshëm të Facebook-ut, që kurrë nuk lodhen duke shpërndarë lajme të rreme, komente fyese dhe shpifje, janë heronjtë e padukshëm të kohës sonë."

444 pëlqime**182** komente**30** shpërndarje

Pëlqej



Koment



Shpërndaj


Një postim publik i deputetes Fitore Pacolli, në të cilin ajo kritikonte keqinformimin, nxiti një zinxhir komentesh armiqësore, ku diskutimi u zhvendos shpejt nga përmbajtja e mesazhit drejt fyerjeve me bazë gjinore, njollosjes së reputacionit dhe akuzave konspirative. Në vend se të debatohej kritika e saj ndaj lajmeve të rreme, komentuesit u përqendruan në

sulme ndaj karakterit dhe kredibilitetit të saj, duke përdorur retorikë moralizuese dhe të ngarkuar politikisht. Modeli dominues pasqyron mënyrën se si gratë në politikë përballen me armiqësi të koordinuar *online*, e cila devijon vëmendjen nga çështjet substanciale dhe ushqen një diskurs të polarizuar dhe abuziv.⁸

⁸ <https://www.facebook.com/462753788565088/posts/1265715641602228>

Kategoria:

Gjuhë urrejtjeje politike me bazë gjinore



Një postim në Instagram nga *Specbuuk*, që citonte Blerta Deliu-Kodra duke vendosur në suaza të caktuara kritikën e saj ndaj kryeministrit, shkaktoi një valë komentesh armiqësore që u zhvendosën shpejt nga mospajtimi politik drejt sulmeve me bazë gjinore dhe identitare. Në vend se të angazhoheshin me komente rreth pretendimit të saj, shumë komentues përdorën etiketime fyese dhe stereotipa gjinorë, duke vënë në dyshim moralin,


inteligjencën dhe legjitimitetin e saj politik. Artikulli ilustron një model të përsëritur në diskutimet *online* rreth grave në politikë: deklaratat politike bien nën hijen e denigrimit personal, vendosjes në suaza identitare dhe tentativave për de-legjitimimin e grave përmes talljes dhe turpërimit moral. Angazhimi në postim pasqyron një përqendrim të lartë të armiqësisë me bazë gjinore në raport me përmasën.⁹

⁹ <https://www.instagram.com/p/dqu-nzhim53/?igsh=mxdtmmu3axnhamw3aw%3d%3d>

AI dhe Deepfake

Sulmet *online* ndaj grave në politikën e Kosovës kanë kaluar nga raste të izoluar në një model më të gjerë digjital që synon minimin e kredibilitetit të tyre. Në vend se të adresojnë politikat apo kualifikimet e tyre, këto sulme fokusohen në jetën personale, pamjen fizike ose elemente vizuale të parëndësishme. Gratë shpesh

paraqiten si “të pakualifikuara” ose “të padenja”, ndërsa seksionet e komenteve tallin pamjen e tyre dhe e devijojnë diskutimin nga puna e tyre politike. Ky trend krijon një mjedis *online* ku legjitimiteti politik i grave vihet vazhdimisht në pikëpyetje, në vend që të merret si i mirëqenë.




Platformat digjitale, posaçërisht TikTok, janë shndërruar në kanale kryesore për

dezinformim të gjeneruar nga AI dhe përmbajtje të bazuara në *meme*, të cilat e

instrumentalizojnë humorin dhe manipulimin kundër grave udhëheqëse. Video të fabrikuar dhe pamje të manipuluar janë përdorur për të trivializuar, seksualizuar ose diskredituar gratë [kandidate], duke shënuar një zhvendosje drejt fushatave shpifëse të përforcuara me mjete teknologjike, ku tallja me bazë gjinore amplifikohet përmes përmbajtjes sintetike.

Një vëzhgim në TikTok evidentoi praninë e një faqeje që duket se publikon video të gjeneruara me AI në mbështetje të Lëvizjes VETËVENDOSJE!, ndërkohë që kritikon ose tall partitë politike rivale. Kjo llogari ka arritur angazhim të konsiderueshëm, ku një video që paraqiste “arrestimin” e supozuar të kryetarit të LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka tejkaluar 500,000 shikime.




Një rast i veçantë u shfaq pas një deklarate publike të Hykmete Bajramit lidhur me bashkëpunimin me Listën Serbe. Si reagim, u fabrikua një video e gjeneruar me AI që e paraqiste atë duke ecur dorë

për dore me një zyrtar të Listës Serbe, e shoqëruar me një mbishkrim fyes që e sulmonte deputeten si në bazë gjinore, ashtu edhe në bazë moshe. Videoja nënkuptonte një marrëdhënie personale që nuk


ekziston, duke kombinuar manipulimin politik me

insinuata gjinore për ta diskredituar publikisht.



Trendi i publikimit të përmbajtjeve të gjeneruara me AI që targetojnë figura politike ka vazhduar dhe është zgjeruar për të përfshirë edhe presidenten aktuale të Kosovës, Vjosa Osmani, si dhe ish-presidenten Atifete Jahjaga. Në këto raste, video të gjeneruara me AI u shpërndanë në rrjete sociale, veçanërisht në TikTok, duke i paraqitur presidentet

duke kërcyer në sfond muzikor *rap*, të shoqëruara me mbishkrime fyese që synonin denigrimin e figurës së tyre publike. Këto përmbajtje nuk trajtojnë rolin apo veprimtarinë e tyre politike, por fokusohen në poshtërimin personal në suaza të stereotipave gjinorë, duke përforcuar targetimin jo-proporcional të grave në politikë në hapësirat *online*.



Faqja në Instagram *Izoliri News*, e krijuar në gusht 2025, postoi një imazh të manipuluar me *photoshop*, që targetonte Besa Shahinin, kandidate për kryetare të Prishtinës.

Imazhi i manipuluar e paraqet atë duke mbajtur kuti rilokimi banese, duke kombinuar një dramë personale të fabrikuar me poshtërim sarkastik, duke e mjegulluar kufirin mes jetës private dhe imazhit publik për ta tallur Shahinin si naive, një arketip i përdorur shpesh në narrativat seksiste për të minuar kredibilitetin e grave.

Kjo përbën një narrativë të rreme të qëllimshme: një histori personale e manipuluar, që përdoret për të sulmuar një grua [politikane], në vend se angazhimi të trajtojë platformën apo kualifikimet e saj.



E tmerrshme:

Besa Shahini me Dardan Molliqajn po e paguanin bashkë banesën me qira, derisa Besa e kuptoi që banesa ishte e Dardanit.

izolirnews



Pëlqej



Koment



Shpërndaj

Duke u fokusuar në detaje të supozuara personale, kjo përmbajtje përforcon stereotipat patriarkale dhe kontribuon në dhunën politike me bazë gjinore, me qëllim

dekurajimin e grave nga aspiratat për role udhëheqëse. E vendosur në suaza humorit, një përmbajtje e tillë e maskon ndikimin e saj real: normalizimin e talljes mizogjene, përhapjen e dezinformimit dhe devijimin e vëmendjes nga debati politik substancial. Postimi arriti angazhim të dukshëm, me 26 pëlqime dhe 151 ndarje.¹⁰

Reagimi i Besa Shahinit ndaj përjashtimit nga një debat televiziv nxiti një valë komentesh seksiste në TikTok, përfshirë thirrje që ajo të “*kthehej në kuzhinë*”, insinuata për jo-stabilitet emocional, apo pretendime se nuk i takonte të ishte pjesë e debatit. Ky rast ilustron mënyrën se si gratë në politikë shpesh përballen me shpërfillje në bazë gjinore kur sfidojnë trajtimin mediatik.



Kur gratë fitojnë – fiton e gjithë shoqëria! Sot u zhvillua mbledhja e V-të e Këshillit të Përgjithshëm të Grave (GVV)



Pëlqej



Koment



Shpërndaj

¹⁰ <https://www.instagram.com/p/dpztrcqjxod/?igsh=mwizndn5ahfrejlkma%3d%3d>

Një postim i shpërndarë nga Lëvizja VETËVENDOSJE! me titullin “*Kur gratë fitojnë – fiton e gjithë shoqëria!*” nxiti debat të gjerë në seksionin e komenteve. Komentet përmbanin tallje, insinuata etnike dhe stereotipa gjinorë, të

përdorura për të riafirmuar normat patriarkale në diskursin publik. Kombinimi i mizogjinisë me animet partiake politike dëshmon se si dezinformimi me bazë gjinore operon në sferën digjitale të Kosovës.






Një postim i Donika Gërvallës me deklaratën: *“Propozimin e bën partia fituese, pikë. Ne kemi propozuar gruan më të votuar të kësaj legjislature...”*, gjeneroi 1,702 angazhime dhe u bë në kontekstin e negociatave politike për

udhëheqjen e Kuvendit. Ndërsa deklarata fokusohet në legjitimitetin procedural dhe përfaqësimin në bazë merite, reagimi publik u degradua kryesisht në fyerje të personalizuara dhe sulme ndaj karakterit. Shkalla e lartë e

angazhimit në komente ilustron se si mospajtimi politik, kur drejtohet ndaj grave, zhvendoset nga debati institucional drejt degradimit moral dhe fizik.

Në vend që të debatohej procesi institucional apo argumenti politik, komentuesit iu drejtuan talljes së pamjes fizike, vënies në dyshim të moralit dhe thirrjes në teori konspirative,

duke reflektuar një model më të gjerë të armiqësisë *online* që synon de-legitimimin e grave përmes poshtërimit, e jo përmes kritikës substanciale. Një retorikë e tillë jo vetëm që dëmton diskursin qytetar, por edhe përforcon norma kulturore që i ndëshkojnë gratë për dukshmërinë dhe autoritetin e tyre në hapësirat politike.



Një postim i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), që përfshinte deklaratën e Hykmete Bajramit pas ndërprerjes së seancës së 48-të konstituive dhe që adresonte shqetësimet lidhur me parregullsitë procedurale të seancës, gjeneroi 958 angazhime. Postimi kishte për qëllim të komunikonte nevojën

për llogaridhënie dhe respekt për rendin institucional.

Megjithatë, reagimet *online* zbuluan sërish një model të armiqësisë përcmuese dhe me bazë gjinore ndaj grave si udhëheqëse politike.

Këto komente pasqyrojnë mënyrën se si pjesëmarrja e grave në kritikën institucionale trivializohet dhe ri-vendoset në

suaza që e paraqesin si mashtruese apo të motivuar nga interesa personale, shpesh përmes etiketimit moral dhe tonit përçmues. Në vend të angazhimit rreth çështjes procedurale të ngritur në

postim, komentuesit u kthyen nga diskreditimi i integritetit të gruas, duke nënkuptuar se roli i saj në politikë nuk është i besueshëm ose thjesht performativ.¹¹

¹¹ <https://www.facebook.com/share/v/1Jbnu5dzQs/?mibextid=wwXlfr>

Komunitet jo-shumicë

Kategoria:

Gjuhë urrejtjeje me motiv gjinor dhe etnik

The screenshot shows a Facebook post from the page 'Sinjali'. The post features a photo of a woman and a text snippet: "Asnjë thirrje, asnjë takim, asnjë bisedë deri tash". Below the photo are engagement metrics: 57 likes, 106 comments, 1 share, and 24 reactions. To the left of the post, a red sidebar displays: 57 pëlqime, 106 komente, and 24 reagime negative. The comments section contains several inflammatory remarks, including: "Po kush je ti qe me pas kurti takim me ty moj...", "Kush je ti met thirr kurti koki met ti e a j...", "Kjo osht ma Serbe se Serbet dhe Kjo duhet mu kontrollu dhe ne fund dalin apo zbulohen veprat penale spiunazhe etj", "Ti te thirr radoqiqi per konsultime e serbis", "Nexhat Shala // Po Hajnat energjetik, t'rezervave Shtetrorre, telekomit Vala t'infrastruktures rrugore etj. etj, kur dot burgosen??", "Nexhat Shala // Met vertetë është mjerim i Shqiptarve n'pergjithsi, ndersa i Kosovarve n'veqanti. Ata t'cilet jan mirë n'mend, dhe akoma s'kanë hailsë, apo (qmend)? edijn mirë se: Ish Luftetaret e UOK-së, prej t'cileve sot disa gjinden: n'Pdk, n'LDK, n'AAK, dhe ne Nisma, janë Ata dhe Ato t'cilet Nasolien Lirinë dhe Shtetin e Kosovës. Ndersa n'vv-ee, sot gjenden: gaz-sjellsit. Buk-permbysnit dhe Tradhtaret e Kosovës dhe t'Shqiptarve. Allabin kuta kovid-19 dhe vv-ja Etij, jan deshmue 100% se jan kundër Vlerave t'Luftes Çlirimtare t'Kosovës, kunder shtetit t'Kosovës, pro varfris dhe Kunder kapitalit, pro kovid-19 dhe vaksinave vdekje-pruse, etj. etj....", "Kushjeti o j...", "Shko trokollitja pak ne burg fatmir shpiunit moj...", "ooo ta baben paramilitar ty e opozites pro serbe", and "Goranke ma,kjo me i ka mire,a e mire sa dush". At the bottom of the post are buttons for 'Pëlqej', 'Koment', and 'Shpërndaj'.


Komentet nën një postim në Facebook të faqes së mediumit *Sinjali*, që kishte në fokus një deputete nga komuniteti

boshnjak, shpërfaqin një model sjelljeje *online* të orientuar drejt minimumit të autoritetit politik të grave. Edhe

pse vetë postimi thjesht raportonte sqarimin e saj lidhur me formimin e qeverisë, seksioni i komenteve u zhvendos shpejt drejt diskreditimit të kompetencës, ndikimit dhe relevancës së saj politike.

Në vend se të angazhoheshin rreth qëndrimit të saj politik, shumë komentues u mbështetën në stereotipa gjinorë dhe etnikë, duke e paraqitur atë si marginale, të

painformuar apo politikisht të parëndësishme. Rrjedha e komenteve përmbante elemente të gjuhës së urrejtjes, talljes së seksualizuar dhe anshmërive etnike, duke e shndërruar një deklaratë rutinë politike në një mundësi për poshtërim publik. Ky reagim pasqyron një dukuri më të gjerë, ku gratë, posaçërisht ato nga komunitetet jo-shumicë, përballen me diskriminim të dyfishtë: de-legitimohen si për shkak të gjinisë, ashtu edhe për shkak të përkatësisë etnike.¹²



¹² <https://www.facebook.com/549932227264595/posts/1139477048310107>

Dhuna *online* ndaj grave në politikë shpesh shfaqet si e organizuar dhe sistematike. Në rastin e monitoruar, deklaratat e një politikaneje serbe të Kosovës nuk nxitën debat politik apo diskutim mbi politika publike, por shkaktuan një valë armiqësie të përqendruar në gjininë, përkatësinë etnike dhe “besnikërinë” e supozuar të saj. Komentet formuan një model të koordinuar sulmesh personale, poshtërimi me bazë gjinore dhe përmes vendosjes në suaza nacionaliste, duke e paraqitur pavarësinë e saj politike si të jo-legjitime. Ky rast pasqyron një trend më të gjerë, ku gratë nga komunitetet jo-shumicë përballen me

diskreditim të dyfishtë: targetohen njëkohësisht si gra dhe si pjesëtare të komuniteteve jo-shumicë. Një ngacmim i tillë e zhvendos vëmendjen nga qëndrimet e tyre politike dhe, në vend të kësaj, vë në pikëpyetje kredibilitetin, moralin dhe përkatësinë e tyre.

Angazhimi i lartë në postim tregon se sa shpejt përhapen këto narrativa armiqësore, duke dëshmuar se si hapësirat digjitale mund të amplifikojnë abuzimin me bazë gjinore dhe me ngjyrimë të ngarkuara etnike, duke e ngushtuar përfundimisht hapësirën për pjesëmarrjen politike të grave.¹³

¹³<https://www.facebook.com/523919106403004/posts/1361877919273781#d666971c002b0af9f41194a691d2cc2b88baa755>

Sensacionalizmi

Kategoria:

Sensacionalizëm dhe stigmatizim i motivuar politikisht



120 reagime

128 komente

86 shikime

 Pëlqej

 Koment


 Shpërndaj

Një postim në Facebook që amplifikonte pretendimin e Jeton Zogjanit se 50,000 votuesit që mbështetën Mimoza Kusarin janë “*nostalgjikë për Jugosllavinë*” gjeneroi angazhim të lartë dhe nxiti një zinxhir komentesh të formësuar nga zemërimi dhe polarizimi. Vetë deklarata është sensacionaliste, pasi përdor gjuhë të ekzagjeruar dhe

stigmatizuese për të diskredituar një grup të gjerë votuesish. Diskutimi që pasoi u zhvendos shpejt drejt armiqësisë partiake, në vend të debatit të bazuar në prova faktike apo politika publike, duke ilustruar se si pretendimet provokuese mund të eskalojnë antagonizmin *online* dhe të shtrembërojnë debatin politik.¹⁴

¹⁴ <https://www.facebook.com/watch/?v=2530274977364244>

Kadrijaj i drejtohet Kusari-Lilës me "Zdravo Mimi" derisa po e mbante fjalimin në Kuvend



105 reagime

43 shpërndarje

121 komente

 Pëlqej

 Koment

 Shpërndaj

Gjatë një seance të përbashkët parlamentare ndërmjet kuvendarëve të Kosovës dhe Shqipërisë, Tíme Kadrijaj mbajti lart një pankartë me mbishkrimin “*Zdravo Mimi*”, në momentin kur Mimoza Kusari-

Lila po mbante fjalimin e saj. Ky gjest shkaktoi një valë reagimesh *online*, ku shumë e interpretuan si një tentativë për ta tallur apo për ta nënçmuar folësen, në vend të trajtimit të përmbajtjes së fjalimit të saj.¹⁵

¹⁵ <https://sinjali.com/kadrijaj-i-drejtohet-kusari-liles-me-zdravo-mimi-derisa-po-e-mbante-fjalimin-ne-kuvend/>

Rekomandime

Analiza e 660,758 komenteve, ku 14% përmbanin gjuhë urrejtjeje ndaj grave, dëshmon se mizogjinia *online* është e mishëruar, e qëndrueshme dhe e përhapur gjerësisht, jo e kufizuar vetëm në ngjarje apo skandale të izoluar. Gratë janë të ekspozuara ndaj ngacmimit të vazhdueshëm, i cili intensifikohet gjatë krizave politike, duke e shndërruar dukshmërinë publike në një faktor risku. Raporti identifikon kategoritë kyç që paraqiten në mënyrë të përsëritur, me qëllim turpërimin e seksualizuar, denigrimin moral, infantilizimin, minimin e

kapaciteteve intelektuale të grave në politikë. Qëndrueshmëria e këtyre modeleve tregon se mizogjinia *online* funksionon si një model socio-politik i rrënjosur, me forma dhe shkaktarë të parashikueshëm.

Me rastin e publikimit të raportit të monitorimit dhe me qëllim adresimin e trajtimit diskriminues dhe gjuhës mizogjene në postimet në rrjete sociale dhe në titujt e mediave online, të cilat minojnë pjesëmarrjen e grave në jetën publike, jepen rekomandimet në vijim:

► **Për mediat dhe redaksitë e lajmeve:**

- Të eliminojnë titujt seksistë, objektivizues ose sensacionalistë dhe të zbatojnë detyrimisht kontrolle redaktoriale të cilësisë para publikimit.
- Të integrojnë udhëzime për raportim të përgjegjshëm gjinor në procedurat redaktoriale, duke forcuar llogaridhënien e brendshme dhe sanksionet për shkelje të përsëritura.

► **Për Këshillin e Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK)**

- Të shtojë monitorimin dhe masat disiplinore ndaj portaleve që përdorin në mënyrë të përsëritur gjuhë seksiste apo tallëse.
- Të bëjë njoftime publike dhe të publikojë buletine të rregullta që evidentojnë shkeljet më të shpeshta.

► **Për institucionet publike dhe politikëbërësit**

- Të integrojnë edukimin mbi barazinë gjinore dhe njohuritë digjitale në kurrikulat shkollore dhe universitare.
- Të zhvillojnë komunikim institucional që siguron përfaqësim të balancuar gjinor në mesazhet publike.
- Të mbështesin mekanizmat e reagimit të shpejtë për rastet e rënda të ngacmimit *online* me bazë gjinore.
- Të financojnë programe trajnimi për gratë në politikë mbi sigurinë digjitale, angazhimin me media dhe menaxhimin e sulmeve *online*.

► **Për platformat e rrjeteve sociale dhe portalet *online***

- Të bëjnë moderim aktiv i komenteve, përfshirë përdorimin e filtrave të automatizuar për fyerjet mizogjene të shpeshta.
- Të heqin shpejt komentet e dhunshme/abuzive dhe t'u japin vërejtje autorëve të shkeljeve të përsëritura.
- Të aplikojnë politika transparente të moderimit, të publikuara hapur në platforma.
- Të krijojnë mekanizma raportimi për dezinformimin e gjeneruar përmes AI, me qëllim manipulimin politik.

► **Për shoqërinë civile dhe organizatat kërkimore**

- Të organizojnë fushata ndërgjegjëse mbi ndikimin e mizogjinisë *online* në pjesëmarrjen në proceset demokratike.

- Të përpilojnë raporte të rregullta monitorimi që dokumentojnë rastet e gjuhës së urrejtjes *online* dhe dezinformimit me bazë gjinore.
- Të krijojnë partneritete me media dhe platforma për zhvillimin e standardeve të përmbajtjes së përgjegjshme gjinore.
- Të mbajnë punëtori për gazetarë, moderatorë dhe redaktorë mbi mbulimin etik të grave në politikë.

► **Për partitë politike**

- Të adoptojnë kode të brendshme të sjelljes që ndalojnë gjuhën seksiste gjatë fushatave apo komunikimit publik.
- Të dënojnë në mënyrë aktive sulmet ndaj grave që janë anëtare të partisë, si brenda partisë ashtu edhe përtej vijave partiake.
- Të ofrojnë mbështetje teknike dhe psikologjike për gratë [kandidate] të ekspozuara ndaj ngacmimit.

► **Për vetë gratë në politikë**

- Të ndjekin trajnime për sigurinë digjitale, komunikimin në krizë dhe dokumentimin e abuzimit.
- Të përdorin kanalet institucionale të raportimit (KMSHK, Avokati i Popullit, policia) për adresimin e rasteve të rënda.
- Të ndërtojnë rrjete mbështetëse me gra të tjera [politikane], përtej ndarjeve partiake, për të adresuar ngacmimin sistemor.

Instituti “Demokrati për Zhvillim” (D4D) është themeluar në prill të vitit 2010 nga një grup i analistëve të cilët ishin gjithnjë e më të shqetësuar se procesi i shtet-ndërtimit e kishte anashkaluar demokracinë. Vizioni i D4D është të promovojë qytetarë aktivë dhe të arsimuar, të cilët marrin pjesë plotësisht në hapësirën publike dhe e përdorin atë për përfaqësim dhe vendimmarrje për të diskutuar dhe ndërtuar konsensus mbi ndarjen e burimeve që janë efikase, të shpejta, afatgjate dhe që çojnë në zhvillim të barabartë. D4D ndikon në politika specifike, promovon një qasje ndërsektoriale ndaj zgjidhjes së problemeve dhe adreson rutinat e vendimmarrjes institucionale duke rekomanduar përmirësime graduale dhe vepron me efektivitet maksimal për të promovuar plotësisht stabilizimin dhe zhvillimin demokratik të Kosovës.



Për më shumë informacion rreth aktiviteteve të D4D, ju lutemi vizitoni faqen tonë të internetit:
www.d4d-ks.org